

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtarin Agim Maliqi kryetar i trupit gjykues, me gjyqtarët profesionistë Ibrahim Idrizi dhe Zenel Tasholli, anëtar, si dhe me asistimin e sekretares juridike Albana Ajvazi, në lëndën penale kundër të akuzuarit N.M., për shkak të veprës penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë, PP nr. 230/2005 të datës 01.07.2005, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Florije Shamolli, të akuzuarit N.M. dhe mbrojtësi i tij me autorizim av. A.I., pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datë 19.12.2013, 06.03.2014, 07.05.2014, 03.06.2014 dhe 05.06.2014, mori dhe publikisht shpalli kurse me datë 30 qershor 2014 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari N.M., nga i ati Sh. dhe E. e gjinisë K., data e lindjes, në fshatin – Ferizaj, me vendbanim në të njëjtin vend, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion bujk, i martuar, babë i gjashtë fëmijëve, din shkrim lexim, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike.

I

ËSHTË FAJTOR

me datën 29.04.2005, rreth orës 02:15 min., në hapësirën në mes restoranteve “...” dhe “...” në Ferizaj, me dashje ka tentuar ta privoj nga jeta të dëmtuarin L.A. në atë mënyrë që pasi i dëmtuari e kishte thyer xhamin e derës së hyrjes së restorantit “...”, pronar i të cilit është i pandehuri dhe pas fjalosjes në mes tyre, i pandehuri e ka nxjerr revolen e tipit “Crvena

Zastava” kal. 7.65 mm, model 70 me numër serik C124402, por kur i dëmtuari ia ka pa atij revolen në dorë ka ikur në drejtim të veturës nga e cila kishte dalë më parë dhe para se të hyj në veturë, i pandehuri nga distanca prej 4-5 metra ka shtënë në drejtim të këmbëve të tij, e pastaj kur i dëmtuari ka hyrë në veturë, i pandehuri është afruar te vetura dhe në xhamin e veturës i cili ka qenë i mbyllur, ka shtënë tri herë në drejtim të të dëmtuarit me të cilin rast i ka shkaktuar lëndime trupore dhe atë në regjionin në kërcirit e dy këmbëve, në regjionin femoral të majtë dhe në anën e majtë të barkut,

- me të cilën kreu veprën penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së.

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 146 lidhur me nenin 20 si dhe neneve 3, 6, 11, 15, 34, 36, 38, 64, 73 dhe nenit 365 të KPPK-ës, i

SHQIPTON

DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 1/NJË/VJET E 6/GJASHTË/MUAJ, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 29 prill 2013 deri më datën 29 maj 2013.

Konform nenit 328 par. 5 të KPK-ës, konfiskohet në mënyrë të përhershme revolen e tipit “Cervena Zastava” kal. 7.65 mm, model 70 me numër serik C124402.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100/njëqind/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, kurse shpenzimet tjera procedurale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate.

I dëmtuari L.A., për realizimin e kërkesës pasurore–juridike udhëzohet në kontest civil.

II

Konform nenit 363 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së

REFUZHET AKUZA

Sepse me datën 29.04.2005, e ka mbajtur pa autorizim një revole të përshkruar në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi, një karikator dhe tre plumba të kalibrit 7.65mm.

- meqë vepra penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, meqë kjo veprë penale është përfshirë në amnisti sipas Ligjit për Amnisti (Ligji nr.04/L-209 dt.19.09.2013).

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

Prokurorisë Publike e Qarkut në Prishtinë, PP nr. 230/2005 të datës 01.07.2005, ka paraqitur aktakuzën PPI. nr. 147/13 të datës 31.10.2013, kundër të akuzuarit N.M., për shkak të veprës penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Rënda, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 19.12.2013, 06.03.2014, 07.05.2014, 03.06.2014 dhe 05.06.2014, kurse i akuzuari u deklarua i pafajshëm, për veprën penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, kurse u deklarua fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare, ka mbetur pranë akuzës ndaj të akuzuarit , për shkak të veprës penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, duke i propozuar Gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënim i paraparë me ligj për këto vepra penale.

2. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, përkatësisht nuk e ka kontestuar faktin se në prill të vitit 2005, ka qenë në motelin e tij “...” që gjendet në Ferizaj, dhe pasi kishte vajtur ora diku në mes 2:00-3:00 e mëngjesit ka qenë duke shkuar për të mbyllur derën e motelit dhe me këtë rast ai kishte dëgjuar një zhurmë që vinte nga hyrja e korridorit jashtë restorantit, para hyrjes, aty ka parë se ishin duke u fjalosur dy persona dhe se dy persona po i ndiqnin dy persona të tjerë dhe ndër personat që po i ndiqshin ka njohur L.K. dhe një person nga Shqipëria, por që me ta së bashku kishin qenë edhe pesë persona të tjerë si grup, kurse personat të cilët iknin dhe u futën në motelin e tij i ka njohur si klient por nuk ia ka ditur emrat, i cili kishte shkuar deri tek dera e motelit, i ka rënë me shqelm derës së motelit duke e thyer atë ashtu që i akuzuari i ka bërëtitur duke i thënë “pse e theve derën, kthehu mbrapa ku po shkon”, por i njëjti duke sharë ka vazhduar të shkoj në drejtim të tij dhe e ka ofruar dorën tek beli, ashtu që i akuzuari në ato momente duke pasur parasysh faktin se këtë person edhe më herët e ka njohur si person problematik dhe i rrezikshëm pasi që disa herë ka bërë probleme në restorant por edhe në lokale të tjera, ka nxjerrë revolen të cilën e ka bartur nga fakti se katër muaj para kësaj ngjarje i është kidnapuar djali i cili një kohë për 7 ditë është mbajtur në Kumanovë dhe atë pikërisht nga ana e këtij personi dhe personave të tjerë që kanë qenë me të, dhe me të nxjerr revolen dhe atë prej derës së hyrjes së motelit ka shtënë njëherë në ajër dhe pas kësaj edhe dy herë në një largësi prej 3-4 m në drejtim të këmbëve të tani të dëmtuarit, në karikator ka pasur edhe 2 apo 3 plumba të tjerë dhe ka mundur që ti shkrep por nuk i ka shkrepur me që i dëmtuari është larguar, i akuzuari shprehet se ka gjuajtur me që këta persona kanë shkuar në drejtim të tij dhe se ishte shumë i sigurt se i dëmtuari kishte armë me vete edhe pse një gjë të tillë nuk e kishte parë, por ishte i sigurt se ai person nuk ecën pa armë asnjëherë. I akuzuari nuk e ka ditur se e ka qëlluar të dëmtuarin me që gjuajtjet i ka bërë në drejtim të tokës dhe para se të gjuaj i është afuar shumë afër i dëmtuari edhe pse personat e tjera i kanë thënë që largohet por i njëjti vazhdimisht ka shkuar në drejtim të tij. Kurse pas

rastit pasi që është liruar nga paraburgimi në shtëpinë e tij kanë ardhur L., babai i tij, vëllai por edhe persona të tjerë të vullnetit të mirë dhe kanë arritur marrëveshje sipas traditave.

4. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari, nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njërën me tjetrën, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akzuarit;
- nga dëshmia e dëshmitarit – të dëmtuarit L.A.;¹
- nga dëshmia e dëshmitarëve M.Gj.,² F.S., M.S., B.G., A.I., N.Z. dhe H.J.³;
- nga leximi dhe shikimi në ekspertizën mjeko-ligjore lidhur me natyrën e lëndimeve të dëmtuarit të dt. 02.06.2005, ku është konstatuar se lëndimet që i ka pësuar i dëmtuari L.A. kualifikohen si lëndime të natyrës së lehtë të shkaktuara nga arma e dorës së zjarrit;
 - nga vërtetimi për marrjen e revoles të dt. 29.04.2005;
 - nga shikimi në fotodokumentacionin që gjenden në shkresat e lëndës;
 - nga procesverbali i dt. 09.07.2005 lidhur me marrëveshjen në mes të familjarëve të akzuarit dhe të dëmtuarit ku i dëmtuari ka deklaruar se nuk i bashkohet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi.

5. Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht Gjykata vlerëson si të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

¹ Shih Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit L.A. dhënë në lokalet e QKUK-së – Klinika Ortopedike në Prishtinë me dt. 06.05.2005, e cila u lexua në shqyrtim gjyqësor, meqë është konfirmuar se i njëjti gjendet jashtë shtetit.

² Shih Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit M.Gj. dhënë në Prokurorinë Publike të Qarkut në Prishtinë me dt. 03.05.2005, e cila u lexua në shqyrtim gjyqësor, meqë është konfirmuar se i njëjti gjendet jashtë shtetit.

³ Shih Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit H.J. dhënë në Prokurorinë Publike të Qarkut në Prishtinë me dt. 30.06.2005, e cila u lexua në shqyrtim gjyqësor, meqë është konfirmuar se i njëjti gjendet jashtë shtetit.

- se ditën kritike 29 prill 2005 rreth orës 02:15, në Ferizaj, në hapësirën në mes restoranteve “...” dhe “...” është shtënë katër herë me revolen e tipit “Crvena Zastava” kal. 7.65 mm, model 70 me numër serik C124402.

- se dera e motelit “...” është thyer nga ana e të dëmtuarit L.A.;

- se i dëmtuari L.A. nga të shtënat e armëve kishte marrë plagë dhe atë vrima hyrëse në anën e majtë të barkut, në kofshën e majtë si dhe në kërcirat e dy këmbëve;

- dhe se të shtënat janë shkrepur nga ana e të akuzuarit.

Por, Gjykata ka pasur për detyrë që në këtë çështje penale të ndriçoj dy versionet e paraqitura si në procedurën hetimore po ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor dhe atë: versionin e Prokurorit të Shtetit (se vrasja në tentativë është kryer me dashje direkte) dhe versionin e akuzuarit dhe mbrojtësit të tij (se kjo vepër nuk ka të bëjë me vrasje porse i akuzuari ka përdorur armën për ti frikësuar neni 328 par. 1 të KPK-së dhe ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor), andaj Gjykata e ndodhur mes këtyre dy versioneve arsyetimin e këtij aktgjykimi do ta përqendron pikërisht në sqarimin e këtyre rrethanave.

I dëmtuari L.A., në dëshminë e tij ka deklaruar se në natën kritike paraprakisht kishin qenë në një kafiteri në Lloshkobare së bashku me M.Gj. nga Shqipëria dhe taksistin F.S. e pas mesnatës aty kishin shkuar edhe një person i quajtur E. me një shok tjetër me ç’rast kishin pirë dhe i dëmtuari ishte bërë qefli dhe ka thyer një shishe të birrës, pas kësaj të gjithë së bashku kanë shkuar në restorant “...” për të ngrënë dhe pasi kanë dalë nga aty derisa po hipnin në veturën e F., e cila ishte në parkingun e restorant “...”, kanë parë dy persona duke dalë nga restoranti “...”, të cilët kanë sharë pastaj edhe këta i kanë sharë dhe kanë hyrë në veturë dhe janë nisur ndërsa personat janë kthyer në motel, pasi kanë ecur me veturë 7- 8 metra ata persona përsëri kanë dalë nga moteli dhe prapë i kanë sharë, pastaj ata kanë dalë nga vetura dhe personat që kanë sharë janë kthyer në recepcion të motelit, dëshmitari është kthyer që të hyjë në veturë dhe në atë rast N. në largësi prej 4-5 me revole në dorë i është drejtuar “ndalu se të vrava” dhe menjëherë ka shtënë me revole të drejtuar nga trupi i tij tri deri në katër herë. Më pas shokët e tij e kanë ndihmuar që të hyj në veturë dhe e kanë dërguar në spital.

Kurse ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike pa arritur të përcaktoj shumën e kompensimit.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari dhe posaçërisht ka pasur parasysh se dëshmitari ishte edhe i dëmtuar në këtë çështje penale, por megjithatë dëshmia e tij është e besueshme e saktë, objektive dhe se në mënyrë mjaft reale ka pasqyruar gjendjen e ndodhur për më tepër dëshmia e tij mbështetet dhe plotësohet nga provat tjera materiale e në rend të parë nga ekspertiza balistike dhe ekspertiza mjeko-ligjore.

Kurse nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit M.Gj. është vërtetuar se i njëjti natën kritike kishte qenë në shoqëri me tani të dëmtuarin L.A., dhe pasi që kishin dalë nga kafiteria "...", përkatësisht në oborrin e kafiterisë ishin fjalosur me dy persona të panjohur, e që këta dy persona pastaj kanë hyrë në kafiteri e pas pak çastesh duke hyrë në veturë vetëm ka dëgjuar një krismë arme e që më vonë e ka parë se N.M. kishte pasur një armë në dorë, në momentin kur L. ka dashur që të hyjë në veturë atëherë N. është ofruar tek dritarja e veturës ku ishte ulur L. dhe duke sharë ka dëgjuar edhe tri të shtëna të njëpasnjëshme përmes dritares ku edhe xhami është thyer dhe pas kësaj janë larguar nga aty, kurse, L. e kanë dërguar deri në ambulancën e Ferizajt, i cili më pastaj është dërguar në Spitalin e Prishtinës.

Dëshmia e këtij dëshmitari është plotësisht e besueshme dhe për më tepër kjo dëshmi tregon ngjarjen vetëm disa ditë pasi që ka ndodhur dhe e përshkruan atë në mënyrë të plotë dhe të qartë deri në detaje edhe pse në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se dëshmitari ka qenë në shoqëri me të dëmtuarin kjo absolutisht nuk e bën *a priori* dëshminë e tij të pabesueshme, për më tepër kjo dëshmi përputhet në tërësi edhe me fotografitë e vendit të ngjarjes sidomos xhamit të thyer të veturës që qartazi shihet se është thyer nga të shtënat e revoles.

Nga dëshmia e dëshmitarit A.I. po ashtu ka vërtetuar faktin se ka qenë në restorant "... " e që duke dalur nga restoranti së bashku me shokun e tij V. janë takuar me tani të dëmtuarin, të cilin në atë kohë e ka njohur se është nga Kumanova, e pas një fjalosje me të dhe shokët e tij që të dy (V. dhe A.) kanë shkuar në drejtim të motelit dhe pasi që e kanë mbyllur derën e motelit personi nga Kumanova (L.A.) ka shkuar pas tyre dhe e ka thyer derën e hyrjes së motelit, e pas kësaj aty ka shkuar edhe pronari i motelit N.M. dhe menjëherë ka gjuajtur një herë me revole në drejtim të këmbëve të të dëmtuarit, e që pas kësaj i dëmtuari dhe personat e tjerë kanë shkuar në drejtim të automjetit të tyre, por N. ka shkuar në drejtim të tyre dhe pas kësaj vetëm ka dëgjuar edhe dy apo tri krisma.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit M.S. kjo dëshmi nuk paraqet kurrëfar relevance për më tepër dëshmia e tij përqendrohet vetëm në faktin se ka dëgjuar krismat e revoles, por, ngjarjen nuk e ka parë me që ka qenë në brendi të restorantit "...", e nga ky fakt duke marrë parasysh se ngjarja ka ndodhur në oborrin e restorantit dhe nuk është kontestuese se pikërisht i akuzuari ka shkrepur me revolen e tij, për këto arsye Gjykata nuk e sheh të arsyeshme që më tutje ta trajtoj dëshminë e këtij dëshmitari.

Nga dëshmia e dëshmitarit B.G. është vërtetuar se i njëjti ngjarjen e ka parë nga terasa e motelit "...", dhe ka parë mirë momentin kur i dëmtuari ka thyer derën e hyrjes, po ashtu ka dëgjuar bisedën në mes N.t dhe L. e për më tepër ka parë momentin kur tani i akuzuari ka gjuajtur dy apo tri herë në drejtim të L.it dhe për këtë arsye ka zbritur shkallëve poshtë që të shoh se çka po ndodh, Gjykata vlerëson se dëshmia e këtij dëshmitari është e saktë dhe objektive, i njëjti pasqyron ngjarjen e zhvilluar dhe jep të dhëna për faktet relevante siç janë thyerja e derës dhe shkrepja me armë e që këto fakte nuk janë kontestuese, e për më tepër kjo dëshmi është në përputhje të plotë me dëshminë e dëshmitarit dhënë gjatë procedurës hetimore.

Nga dëshmia e dëshmitarit F.S., kuptojmë që i njëjti natën kritike ishte duke i vozitur si taksist tani të dëmtuarin L.A., M.Gj. dhe H.J. e që rreth orës 02:00 kanë shkuar tek restorant "...", e që L. e ka goditur derën e hyrjes së motelit e që pas kësaj N. ka nxjerr revolen dhe ka gjuajtur dy deri në tri herë me ç'rast L. ka marrë lëndime në pjesën e poshtme të trupit dhe duke ikur ka hyrë në veturën e tij dhe pastaj e ka dërguar në spital. Duke shtuar më tutje faktin se L. atë natë ka qenë në gjendje të dehur pasi paraprakisht kishte konsumuar pije edhe në një restorant në fsh. Lloshkobare, duke mos kontestuar faktin se xhami i veturës së tij ka qenë i thyer por pa pasur njohur se kush e ka thyer.

Ndërsa dëshmitari N.Z. gjatë deklaramit të tij ka dëshmuar se në kohën kur ka ndodhur ngjarja ka qenë duke punuar në cilësinë e recepcionistit në motelin "...", se së pari ka dëgjuar një zhurmë dhe sharje e cila është zhvilluar në motelin e hotelit, e që pas kësaj ka parë kur N. e ka nxjerrë revolen dhe ka shtënë një herë përpjetë dhe pastaj edhe dy herë poshtë duke mos e ditur se çka ka ndodhur më tutjt si pasoj e frikës dhe shqetësimit për rastin e ndodhur, e që dëshmia e tij nuk është e besueshme në faktet që i prezenton përkatësisht i njëjti qartazi i shmang përgjigjet duke u arsyetuar në frikë dhe shqetësim e për më tepër i njëjti ka qenë i punësuar tek motel "...", pronar i së cilës është i akuzuari, andaj dëshmisë së

tij Gjykata i besoj vetëm në ato fakte, të cilat janë vërtetuar përmes provave të tjera, përkatësisht sharjeve dhe shkrepjes me armë, për më tepër se dëshmia e tij është e pa qëndrueshme sidomos në rrethanën se i akuzuar paska gjuajtur përpjetë dhe poshtë.

Ndërsa nga dëshmia e dëshmitarit H.J., është sqaruar se i njëjti ditën kritike ka qenë i shoqëruar me L.A. dhe M.Gj., se në oborrin e restorant “...” kanë pasur një fjalosje me dy persona të tjerë, të cilët pasi kanë hyrë në motel i kanë ndjekur ata deri tek hyrja e motelit, e që në ato momente ka dal N.M. i cili ka shtënë dy herë në drejtim të këmbëve të L. e që pas kësaj ai së bashku me L. kanë hyrë brenda në veturë e që N. ka shtënë edhe disa herë me revole nga dritarja e thyer e veturës, duke e goditur në pjesën e barkut L..

Nga shikimi në fotoalbumin, skicën dhe fotografitë në vendngjarjen e datës 29.04.2005, shihet vetura e tipit “Opell Omega” me xhamin e derës së pasme të majtë të thyer, xhami i derës së motelit i thyer, një fishek i kalibrit 7.65 mm, tri gëzhoja të të njëjtit kalibër të gjetura në kontejnerin e mbeturinave në oborrin e restorantit, si dhe revolva e tipit “Crvena Zastava 70” e kalibrit 7.6mm me nr. serik C124402.

Nga leximi i mendimit të ekspertizës mjeko ligjore të datës 02.06.2005, janë përshkruar plagët e të dëmtuarit L.A.⁴ dhe duke përfunduar konkluzionin se lëndimet janë të kualifikuara si lëndim i lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Gjykata mendimit të përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Prof. Dr. N.H., i ka falur besim të plotë me që e njëjta është përpiluar në të arritura shkencore, në mënyrë profesionale, për më tepër janë përshkruar në mënyrë të detajuar plagët që ka pësuar i dëmtuari, si dhe natyrën e lëndimeve trupore të tij, e që nuk është gjetur ndonjë rrethanë objektive apo subjektive që do ta dëmtonte besueshmërinë e këtij raporti.

6.Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit dhe pretendimeve të mbrojtësit të të akuzuarit

Mbrojtja e të akuzuarit në fazën hetimore por edhe në fazën e shqyrtimit gjyqësor është përqendruar në paraqitjen se veprimi i tij ka qenë si reagim i të dëmtuarit me që i njëjti fillimisht kishte thyer derën e restorantit dhe kishte hyrë brenda, e po ashtu përkundër faktit se ishte tërhequr vërejtja nga ana e të akuzuarit që të kthehej prapa i njëjti kishte vazhduar

⁴ Shih mendimin e ekspertit mjeko-ligjor.

duke e vendosur dorën në bel, e që nga frika se i dëmtuari po e sulmon, duke e njohur më herët si person problematik më pastaj i akuzuari njëherë ka shtënë në ajër e që pas kësaj edhe dy herë në drejtim të këmbëve të të dëmtuarit.

Mbrojtja e të akuzuarit është pjesërisht e qëndrueshme sidomos në paraqitjen e fakteve se ka shtënë tri herë dhe atë një herë në ajër dhe dy herë në drejtim të këmbëve të të dëmtuarit, kurse sa i përket pjesës tjetër të mbrojtjes së tij është në tërësi e paqëndrueshme dhe në kundërshtim me të gjitha provat tjera të prezantuara e sidomos me ekspertizën mjeko – ligjore, në të cilën janë konstatuar se i dëmtuari është goditur edhe në pjesën e barkut, që demanton në tërësi pohimet e të akuzuarit se gjuajtjet kanë qenë në drejtim këmbëve të tij.

Po ashtu pretendimi tjetër i të akuzuarit që ndërlidhet me faktin se pikërisht tani i dëmtuari disa muaj para ngjarjes kishte kidnapuar djalin e tij edhe ky pretendim i tij është i paqëndrueshëm edhe pse është i saktë pohimi se djali i të akuzuarit ishte kidnapuar dhe ishte mbajtur në Kumanovë, mirëpo nuk është vërtetuar me asnjë provë konkrete fakti se pikërisht i dëmtuari kishte kryer një veprim të tillë, për më tepër është vërtetuar në mënyrë të qartë edhe përmes dëshmitarëve të tjerë se i dëmtuari edhe më herët kishte frekuentuar lokalin ku ishte pronar i akuzuari dhe asnjëherë nuk kishin biseduar për këtë çështje. E për më tepër edhe vet zhvillimi i ngjarjes ditën kritike tregon rastësinë e takimit në mes të akuzuarit dhe të dëmtuarit, me që këtij takimi i kishte paraprirë një fjalosje dhe sharje në mes të të dëmtuarit L.A. dhe dëshmitarit H.J. në njërin anë dhe të dëshmitarit A.I. në anën tjetër të cilët kishin hyrë në motel dhe gjatë përleshjesh kishin thyer xhamin e motelit të restorantit ku ishte pronar i akuzuari, e që i akuzuari me rastin e dëgjimit të zhurmës as që kishte idenë se kush ishin personat që ishin duke u fjalosur.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit, av. A.I. të paraqitur në fjalën përfundimtare, të cilën e ka deponuar në formë të shkruar duke propozuar që i akuzuari të lirohet nga akuza për veprën penale vrasje në tentativë me që nuk është vërtetuar me asnjë provë konkrete se i akuzuari të ketë kryer këtë vepër penale, duke vazhduar më tutje se i akuzuari nuk e ka kontestuar faktin se ka përdorur revolen e tij, por këtë e ka përdorur duke shkrepur një herë në ajër dhe dy herë në drejtim të këmbëve të tij e që në karikatorin e revoles së tij kishte edhe plumba të tjerë, por, të njëjtit nuk i përdori nga fakti se tani i dëmtuari ishte larguar nga oborri i restorantit, e që në fakt i akuzuari kishte mundësi që po të donte të qëllonte të dëmtuarin edhe në pjesët vitale të trupit.

Por, Gjykata vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit janë të paqëndrueshme nga arsyetimi që do të paraqitet si më poshtë:

Së pari është vërtetuar në mënyrë të padyshimt se i akuzuari ka shtënë edhe në pjesën e epërme të trupit dhe atë përmes ekspertizës mjeko-ligjore ku vërtetohet se i dëmtuari në mes lëndimeve tjera kishte edhe një lëndim në anën e majtë të barkut, e këtë fakt duke e ndërlidhur po ashtu me faktin tjetër se nuk ka se si të determinohet ndryshe dashja e të akuzuarit për të kryer këtë vepër penale pos faktit se i njëjti ka shtënë katër herë në drejtim të të dëmtuarit dhe atë njëherë porsa del nga restoranti dhe tri herë derisa tani i dëmtuari gjendej në karrigen e pasme te veturës;

Po ashtu edhe pretendimi tjetër se të shtënat me armë kanë qenë të nevojshme për zmbarsjen e sulmit nga ana e të dëmtuarit po ashtu nuk qëndrojnë ngase është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se mosmarrëveshjet kanë filluar në mes të të dëmtuarve, shokëve të tij dhe personave të tjerë, kurse më vonë del nga restoranti tani i akuzuari dhe i njëjti me asnjë veprim nuk ishte involvuar në zënkën paraprake të tyre. fakti se është shtënë tri herë në drejtim të të dëmtuarit

7. Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit

Gjykata vlerëson se në veprimet e të akuzuarit, janë plotësuar të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, e cila përcaktohet edhe nga përshkrimi ligjor i dispozitës është përcaktuar: “*Kushdo që e privon nga personin tjetër nga jeta*”, kurse edhe nga përshkrimi ligjor i dispozitës së nenit 20 të KPK-së është përcaktuar:

“ Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale ”

Nga kjo rrjedhimisht është e pakontestueshme që i akuzuari, ka shtënë së pari një herë porsa ka dal nga hyrja e restorantit e pastaj edhe tri herë të tjera derisa i dëmtuari ishte i ulur në pjesën e pasme të automjetit e që një predhë e godet në pjesën e barkut, e që janë realizuar në tërësi tiparet objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale dhe atë:

elementi *actus reus (elementi i jashtëm)*, i vërtetuar përmes faktit se kemi të bëjmë me tentim të privim nga jeta të personit tjetër duke i ndërlidhur me ekzistimin e :

-lidhjes kauzale mes veprimit të akuzuarit dhe pasojës së mundshme i realizuar përmes shkrepsjes me pistoletë;

- e që predhat e shkrepsura ishte e drejtuar drejtpërdrejt në të dëmtuarin në largësi 4 - 5 m.;

- dhe njëra predhë e godet të dëmtuarin në anën e majtë të barkut duke i shkaktuar lëndim të lehtë trupor pa rrezikuar jetën e tij.

Kurse elementi i lartcekur ndërlidhet edhe me elementin mens rea (qëllimi i brendshëm mendor kriminal), i vërtetuar përmes veprimeve konkrete të të akuzuarit:

- se i akuzuari ishte i vetëdijshëm se përmes veprimit të tij të manifestuar përmes shkrepsjes në pjesën vitale të trupit anën e majtë të barkut do të mund të shkaktonte vdekje;

- i shprehur edhe përmes aspektit volutiv, se vet shkrepsja e predhës në drejtim të të dëmtuarit, për më tepër i vazhdimet edhe më tutje duke shtënë edhe me predhën e tretë po në drejtim të të dëmtuarit tregon dashjen direkte për kryerjen e kësaj vepre penale.

8. Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimin për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese mori mënyrën e kryerjes së veprës penale se edhe i dëmtuari ishte person problematik dhe i shoqëruar nga persona tjerë po ashtu të këtij rangui dhe se padyshim mënyra dhe koha e shkuarjes po shkaktonte frikë tek i akuzuari e këtë fakt duke e ndërlidhur me sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, se kanë tejkalluar mosmarrëveshjet me të dëmtuarin, se veprën penale e kishte kryer nën rrethana specifike nga fakti se disa muaj më parë ishte kidnapuar djali i tij nga persona të panjohur dhe tek i njëjti ishte paraqitur një pasiguri, kurse me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese nuk gjeti ndonjë të tillë, pos, që vlerësoj shkallën e rrezikshmërisë të kësaj vepre penale.

Gjykata është e bindur se me anë të këtij dënimi nën minimumin e përcaktuar ligjor është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 34 të KPK-

ës, dhe me këtë dënim që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit, se me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

9.Konfiskimi, llogaritja e paraburgimit, kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Gjykata konform nenit 328 par.5 të KPK-ës, konfiskohet në mënyrë të përhershme revolen e tipit “Crvena Zastava” kal. 7.65 mm, model 70 me numër serik C124402, një karikator dhe tre plumba të kalibrit 7.65mm., meqë me dispozitë përkatëse është përcaktuar konfiskimi i obliguar.

Në dënimin e shqiptuar është llogaritur koha e qëndrimit në paraburgim të akuzuarit duke aplikuar nenin 71 par. 1 të KPK-ës.

Konform nenit 463 par.2 të KPPK-së, Gjykata ka udhëzuar të dëmtuarin L.A., që realizimin e kërkesës pasurore –juridike mund ta realizon në kontest civil, meqë nga të dhënat e siguruara gjatë procedurës penale nuk japin të dhëna të plota e as të pjesërishme për të vendosur lidhur me këtë kërkesë.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, Gjykata obligoi të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 100 /njëqind/€ dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, e cila është caktuar duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të akuzuarit dhe komplikueshmërinë e kësaj çështje penale.

Kurse sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, Gjykata ka refuzuar akuzën konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së, pasi që ka konstatuar faktin se kjo veprë penale është përfshirë në amnisti sipas Ligjit për Amnisti (Ligji nr.04/L-209 dt.19.09.2013).

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me P.nr.409/05 PR1.

**Sekretarja juridike,
Albana Ajvazi**

**Kryetari i trupit gjykues,
Agim MALIQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, kurse i dëmtuari mund të ushtroj ankesë ndaj këtij aktgjykimi vetëm për vendimin e Gjykatës lidhur me sanksionin penal.